



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Kavajë, më ____ . ____ . 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ . 2026

**“PËR NDRYSHIMIN E VKB NR 59, DATË 16.12.2025
“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026 DHE PBA 2026-2028”.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Kryetari Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës:

TË VENDOSI:

1. Ndryshimin e VKB nr 59, datë 16.12.2025 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2026 dhe PBA 2026-2028”, përsa i përket pikës nr 4 të këtij vendimi.
2. Numri i punonjësve në pikën 4 të VKB nr 59 datë 16.12.2025, ndryshohet nga 772 (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) në 855 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë).
3. Efektet buxhetore janë të miratuara në VKB nr. 20, datë 25.03.2026 “Shtesë mbi VKB nr 59, datë 16.12.2025 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2026 dhe PBA 2026-2028”
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Frida Gjuzi

DREJTORIA LIGJORE
Helidon Plaku

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
Albi Lushkja

DREJTORIA E SHËRBIMEVE
Mario Kolë

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
Jurgen Kariqi

DREJTORIA E KULTURES DHE SPORTEVE
Gentian Jaupi

DREJTORIA E TRASHEGIMISË KULTURORE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT
Bashkim Krasniqi

DREJTORIA E CERDHEVE DHE QENDRES DITORE PER FEMIJET
Romina Kala

AGJENCIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR
Edmond Curumi

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Meri Biturku

KRYETARI
FISNIK QOSJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

DREJTORIA E ÇERDHEVE DHE QENDRES DITORE TE FEMIJEVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR “NGJYRAT E JETES”

Nr _____ Prot

Kavajë me ____ / ____ /2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Kavajë

Nga: Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Lënda: Kërkesë për shtesë personeli në institucionet në varesi të kësaj drejtorie.

1. Hyrje

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të kujdesit dhe edukimit për fëmijët e moshës 0-3 vjeç, si dhe të mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara ka kryer një analizë të gjendjes aktuale të institucioneve përkatëse në territorin e Bashkisë Kavajë.

Nga kjo analizë është konstatuar se Çerdhja Nr. 1 Kavajë po përballlet me mbingarkesë të ndjeshme të numrit të fëmijëve, përtej kapacitetit fizik dhe stafit ekzistues; ndërkohë që Çerdhja e Golemit dhe Çerdhja e Luzit të Vogël, megjithëse janë konceptuar dhe ndërtuar brenda godinave të kopshteve përkatëse, nuk funksionojnë aktualisht për shkak të mungesës së stafit, ndonëse kanë tashmë fëmijë të regjistruar dhe janë plotësisht të përgatitura për nisjen e veprimtarisë.

2. Gjendja aktuale

- Çerdhja Nr. 1 Kavajë: aktualisht e mbingarkuar me fëmijë përtej kapacitetit.
- Çerdhja e Golemit: godinë funksionale, pjesë e kopshtit, me fëmijë të regjistruar, por pa staf aktiv.
- Çerdhja e Luzit të Vogël: në të njëjtën situatë, me strukturë të përgatitur dhe regjistrime të kryera, por pa staf aktiv.



3. Kërkesë për shtesë personeli në çerdhe

Për të siguruar funksionimin e rregullt të çerdhes së re ,kërkohet shtesa e 7 punonjësve të rinj, si vijon:

- **Për Çerdhen Nr. 2 Kavajë (140 fëmije te regjistruar ne cerdhen aktuale)**

- 1 (një) Kuzhinieri
- 1 (një) Ndihmës kuzhinieri
- 1 (një) Sanitare
- 1 (një) Roje

- **Për Çerdhen e Golemit (30 fëmije te regjistruar)**

- 3 (tre) Kujdestare
- 1 (nje) Sanitare
- 1(ne) Ndihmes Kuzhinier

- **Për Çerdhen Luz i Vogel (10 fëmije te regjistruar)**

- 1 (nje) Kujdestare
- 1(ne) Ndihmes Kuzhinier

Shënim: Çerdhet e Golemit dhe Luzit të Vogël janë tashmë pjesë e godinave të kopshteve përkatëse, me fëmijë të regjistruar. Funksionalizimi i tyre kërkon vetëm emërimin e stafit të nevojshëm, pasi infrastruktura dhe pajisjet bazë janë të përgatitura e cila aktualisht funksionon si Kopesht-Cerdhe.

4. Kërkesë për shtesë personeli në Qendrën Ditore të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Kavajë

Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ofrohen në Qendrën Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, kërkohet shtesa e 1 specialisti profesionalë si më poshtë:

1. 1 (një) Psikologe – për ndjekjen dhe mbështetjen emocionale, zhvillimore dhe sociale të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

5. Përfundime dhe rekomandime


Bazuar në analizën e mësipërme, Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara rekomandon që Këshilli Bashkiak Kavajë të miratojë:


1. Shtesën e 11 punonjësve të rinj për çerdhet (në Kavajë, Golem dhe Luz i Vogël).
2. Shtesën e 1 specialistëve (Psikologe dhe Logopede) për Qendrën Ditore të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

DREJTORI

Romina KALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE

Nr. _____ prot.

Kavajë, më ____ . ____ .2026

LËNDA : Kërkese për shtesë organike dhe miratimin e strukturës së re të Policisë Bashkiake

DREJTUAR : Kryetarit të Bashkisë Kavajë Z. Fisnik QOSJA

PËR DIJENI : Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorisë së Burimeve Ekonomike, Drejtorisë së Burimeve Njerzore.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2/1, nenit 9 pika 1.1, shkronja "b"/2, nenit 54 shkronja 'ç'/3, nenit 55 pika 2/4, ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar të ligjit nr.10405, datë 23.04.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", Vendimit nr.328 datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar të ligjit 89/2022 datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake", ju parashtrojmë relacionin dhe kërkesën si më poshtë vijon:

Në kuadër të ndryshimeve në ligjin nr.89/2022 në Nenin 7 "Organizimi dhe funksionimi i Policisë Bashkiake" citohet:

1.Policia Bashkiake organizohet në strukturë organizative hierarkike në nivel drejtorie ose sektori

2.Kryetari i Bashkisë miraton strukturën e Policisë Bashkiake.

3.Këshilli Bashkiak miraton buxhetin dhe numrin maksimal të Punonjësve të Policisë Bashkiake, si dhe në nenin 28 "Trajtimi financiar gjatë dhe pas përfundimit të mardhënive të punës" ku citohet se:

3/1.Paga e punonjësit të Policisë Bashkiake miratohet nga Këshilli Bashkiak në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe shpërblimet.


Në vijim të këtyre ndryshimeve në nenin 53, të ligjit nr.8224 datë 15.05.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe Komunës", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij shfuqizohen.

Nisur nga ndryshimet e sipërcituara, për të ofuruar një shërbim sa më dinjitoz qytetarëve ndjehet si domosdoshmëri ristrukturimi i Policisë Bashkiake. Kjo strukturë e re e bën më të thjeshtë koordinimin dhe ndarjen e përgjegjësive të gjithëseclilit.

Policia Bashkiake e Kavajës ka një organikë prej 36 (tridhjetë e gjashtë punonjësish) duke përfshirë këtu Drejtorin, Përgjegjës, Juristin si dhe punonjësit e Policisë për Bashkinë e Kavajës si dhe për Njësitë Administrative Helmas, Luz i Vogel, Synej, Golem. Për efekt të kontrollit sa më mirë të teritorit, për një Polici Bashkiake sa më pranë qytetarëve të Kavajës duke marrë parasysh që në sezonin veror popullsia në qytetin e Kavajës si dhe në katër Njësitë Administrative që mbulon kjo Bashki pothuajse 2-fishohet si në njerëz po ashtu dhe për sa i përket automjeteve si dhe jemi në prag të një marrëveshje me Ministrinë e Brëndëshme për një akses në sistemin E-GJOBA për të bërë të mundur futjen në sistemin e Policisë Shtetit edhe gjobat e Policisë Bashkiake të Kavajës si dhe për çdo problematikë që mund të kenë qytetarët gjatë gjithë kohës 24 orë kërkoj që organika e efektivit të Policisë Bashkiake "**të shtohet**" me 6 (gjashtë) punonjës bazuar në strukturën organizative hierarkike që parashikohet në ligjin e ri 89/2022 datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake". Konkretisht 6 (gjashtë) punonjës/e Policie.

Sa më sipër kërkojmë miratimin e kësaj strukture si dhe përcaktimin e nivelit të pagave sipas akteve ligjore në fuqi.

DREJTORI
ALBAN SHARRA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më ____ . ____ .2026

LENDË:Relacion per shtese punonjesish ne organiken e Drejtorise se Burimeve
Ekonomike**DREJTUAR:**Drejtorise se Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese

PER DIJENI: KRYETARI I BASHKISE

Në kuadër të përmirësimit të funksionimit të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike dhe rritjes së efikasitetit në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe administrative, paraqitet nevoja për shtesë në organikën aktuale me 3 (tre) specialistë të rinj në fushën e financës, kryesisht në Sektorin e Finance Kontabilitetit.

Stafi ekzistues është i ngarkuar mbi kapacitetet optimale, gjë që ndikon në afatet e përgatitjes së raporteve financiare dhe lind nevoja e shtesës në organikën e kësaj drejtorie.

Shtimi i 3 specialistëve do të mundësojë:

- Përmirësimin e menaxhimit dhe delegimit të funksioneve për çdo specialist;
- Rritjen e saktësisë dhe shpejtësisë së përgatitjes së raporteve financiare;
- Forcimin e kontrollit të brendshëm financiar;
- Uljen e ngarkesës në procesin e punës për stafin ekzistues.
- Përmbushjen në kohë të detyrimeve ligjore dhe raportuese.

Duke marrë parasysh rëndësinë e funksionimit të saktë dhe efikas të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike, si dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve njerëzore, propozohet miratimi i shtesës në organikë me 3 (tre) specialistë finance si më poshtë :

- 1-Specialist i Administrimit të Magazinës
- 2-Specialist për Sektorin Finance-Kontabilitet
- 3-Specialist për Raportimet Financiare periodike për MF, AMVV, DFV etj

Për këto arsye, kërkohet shqyrtimi dhe miratimi i këtij propozimi.

DREJTORI
ALBI LUSHKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

DREJTORIA E KULTURËS DHE SPORTEVE

DREJTORIA E TRASHËGIMISË KULTURORE, TURIZMIT DHE PROMOVIMIT TË QYTETIT

Nr _____ Prot _____

Kavajë me ____ / ____ /2026

RELACION

Lënda: Propozim për shtim stafi në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve dhe në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Promovimit të Qytetit

Drejtuar: Kryetar i Bashkisë Z.FISNIK QOSJA

Për dijeni: Sekretari i Përgjithshëm Adrian Malaj

Për dijeni: Drejtor i Burimeve Ekonomike Z.Albi Lushka

Në kuadër të rritjes së aktiviteteve kulturore dhe sportive, nevojës për përmirësimin e organizimit dhe ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, si edhe për të promovuar sa më mirë Bashkinë e Kavajës duke qenë që turizmi përbën një nga të ardhurat kryesore, kërkojmë shqyrtimin e mundësisë për shtimin e 8 (tetë) vende pune në Drejtorinë e Kulturës dhe Sportit me pozicione si; 4 (katër) Specialist Sporti, 2 (dy) Specialist Kulture, 2 (Specialist Muzike) dhe 5 (pesë) vende pune në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Promovimit të Qytetit me pozicione si; 3 (tre) Specialist Turizmi, 2 (dy) Specialist Muzike.

Ngarkesa në rritje e punës, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore e sportive, si dhe nevoja për mbështetje më të madhe administrative dhe organizative, e bëjnë të domosdoshëm forcimin e kapaciteteve njerëzore të të dyjave drejtorive.

Për sa më sipër, lutemi të merret në konsideratë miratimi i shtimit të vendeve të punës, në funksion të përmbushjes sa më cilësore të detyrave institucionale.

DREJTOR I KULTURËS

GENTIAN JAUPI

DREJTOR I TURIZMIT

BASHKIM KRASNIQI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE, TË ARDHURAVE DHE BORXHIT

Nr. _____ prot.

Kavajë, më ____ . ____ . 2026

Lënda: Kërkesë për shtim të numrit të punonjësve në strukturën e DTTVAB

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë, Z. Fisnik Qosja

Sekretarit të Përgjithshëm, Z. Adrian Malaj

RELACION
PËR SHTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË DREJTORINË E TAKSAVE,
TARIFAVE VENDORE, TË ARDHURAVE DHE BORXHIT

Ky relacion hartohet me qëllim evidentimin e nevojës për shtimin e numrit të punonjësve në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, si rezultat i rritjes së volumit të punës, zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, shtimit të funksioneve administrative dhe nevojës për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe subjekteve private.

I. GJENDJA AKTUALE

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit aktualisht ushtron funksionet e saj me një numër të kufizuar punonjësish, të cilët mbulojnë:

- administrimin e taksave dhe tarifave vendore;
- identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve tatimpaguese;
- përlllogaritjen dhe ndjekjen e detyrimeve;
- arkëtimin dhe monitorimin e të ardhurave vendore;
- verifikimet në terren;
- trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve;
- raportimin periodik financiar dhe statistikor.

Gjatë periudhës së fundit është konstatuar një rritje e ndjeshme e numrit të subjekteve aktive, volumit të dosjeve administrative dhe kërkesave për shërbim, çka ka sjellë mbingarkesë të stafit ekzistues dhe vështirësi në realizimin në kohë dhe me efikasitet të detyrave funksionale.



II. ARSYET E KËRKESËS PËR SHTIM PERSONELI

Nevoja për shtim të numrit të punonjësve mbështetet në këto argumente:

1. Rritja e numrit të tatimpaguesve

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në territorin e bashkisë, sidomos në zonën turistike të Golemit, ka sjellë shtim të subjekteve tregtare dhe familjare që duhet të administrohen nga drejtoria.

2. Rritja e volumit të procedurave administrative

Proceset e verifikimit, njoftimit, mbledhjes së detyrimeve dhe ndjekjes së debitorëve kërkojnë angazhim më të madh njerëzor.

3. Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave vendore

Shtimi i stafit do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e eficiencës së administrimit fiskal dhe në uljen e nivelit të detyrimeve të pambledhura.

4. Nevoja për kontrolle në terren

Aktualisht numri i inspektimeve dhe verifikimeve në terren është i pamjaftueshëm për shkak të mungesës së burimeve njerëzore.

5. Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve

Rritja e fluksit të qytetarëve dhe subjekteve kërkon më shumë kapacitete administrative për ofrimin e shërbimeve brenda afateve ligjore.

III. PROPOZIMI

Për sa më sipër, propozohet:

- shtimi i 3 (tre) punonjësve në strukturën organike të Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit;
- pozicionet e propozuara të jenë:
 - Inspektor terreni;
 - Specialist për ndjekjen e debitorëve;
 - Specialist i shërbimit ndaj tatimpaguesve.

Numri dhe profilet përkatëse të përcaktohen në përputhje me nevojat funksionale dhe mundësitë buxhetore të institucionit.

IV. EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij propozimi do të sjellë:

- rritje të nivelit të arkëtimit të të ardhurave vendore;
- përmirësim të administrimit fiskal;
- ulje të ngarkesës së stafit ekzistues;
- rritje të kontrollit dhe verifikimeve në terren;
- ofrim më cilësor dhe më të shpejtë të shërbimeve për qytetarët dhe biznesin;
- rritje të performancës institucionale të bashkisë.

V. KONKLUZION



Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të volumit të punës dhe nevojës për forcimin e administrimit të të ardhurave vendore, vlerësohet i domosdoshëm shtimi i numrit të punonjësve në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit Për këtë arsye, kërkohet miratimi i propozimit për ndryshimin e strukturës organike dhe shtimin e personelit sipas nevojave të paraqitura më sipër.

Duke shpresuar në miratimin tuaj,

**DREJTORI I TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE,
TË ARDHURAVE DHE BORXHIT**

Jurgen Kariqi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAVAJË

DREJTORIA E ÇERDHEVE DHE QENDRES DITORE TE FEMIJEVE ME AFTESI TE KUFIZUAR “NGJYRAT E JETES”

Nr _____ Prot

Kavajë me ____ / ____ /2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Kavajë

Nga: Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Lënda: Kërkesë për shtesë personeli në institucionet në varesi të kësaj drejtorie.

1. Hyrje

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të kujdesit dhe edukimit për fëmijët e moshës 0-3 vjeç, si dhe të mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara ka kryer një analizë të gjendjes aktuale të institucioneve përkatëse në territorin e Bashkisë Kavajë.

Nga kjo analizë është konstatuar se Çerdhja Nr. 1 Kavajë po përballet me mbingarkesë të ndjeshme të numrit të fëmijëve, përtej kapacitetit fizik dhe stafit ekzistues; ndërkohë që Çerdhja e Golemit dhe Çerdhja e Luzit të Vogël, megjithëse janë konceptuar dhe ndërtuar brenda godinave të kopshteve përkatëse, nuk funksionojnë aktualisht për shkak të mungesës së stafit, ndonëse kanë tashmë fëmijë të regjistruar dhe janë plotësisht të përgatitura për nisjen e veprimtarisë.

2. Gjendja aktuale

- Çerdhja Nr. 1 Kavajë: aktualisht e mbingarkuar me fëmijë përtej kapacitetit.
- Çerdhja e Golemit: godinë funksionale, pjesë e kopshtit, me fëmijë të regjistruar, por pa staf aktiv.
- Çerdhja e Luzit të Vogël: në të njëjtën situatë, me strukturë të përgatitur dhe regjistrime të kryera, por pa staf aktiv.



3. Kërkesë për shtesë personeli në çerdhe

Për të siguruar funksionimin e rregullt të çerdhes së re ,kërkohet shtesa e 7 punonjësve të rinj, si vijon:

- **Për Çerdhen Nr. 2 Kavajë (140 femije te regjistruar ne cerdhen aktuale)**

- 1 (një) Kuzhinieri
- 1 (një) Ndhmës kuzhinieri
- 1 (një) Sanitare
- 1 (një) Roje

- **Për Çerdhen e Golemit (30 femije te regjistruar)**

- 3 (tre) Kujdestare
- 1 (nje) Sanitare
- 1(ne) Ndhmes Kuzhinier

- **Për Çerdhen Luz i Vogel (10 femije te regjistruar)**

- 1 (nje) Kujdestare
- 1(ne) Ndhmes Kuzhinier

Shënim: Çerdhet e Golemit dhe Luzit të Vogël janë tashmë pjesë e godinave të kopshteve përkatëse, me fëmijë të regjistruar. Funksionalizimi i tyre kërkon vetëm emërimin e stafit të nevojshëm, pasi infrastruktura dhe pajisjet bazë janë të përgatitura e cila aktualisht funksionon si Kopesht-Cerdhe.

4. Kërkesë për shtesë personeli në Qendrën Ditore të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Kavajë

Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ofrohen në Qendrën Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, kërkohet shtesa e 1 specialisti profesionalë si më poshtë:

1. 1 (një) Psikologe – për ndjekjen dhe mbështetjen emocionale, zhvillimore dhe sociale të fëmijëve dhe familjeve të tyre.



5. Përfundime dhe rekomandime


Bazuar në analizën e mësipërme, Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara rekomandon që Këshilli Bashkiak Kavajë të miratojë:

1. Shtesën e 11 punonjësve të rinj për çerdhet (në Kavajë, Golem dhe Luz i Vogël).
2. Shtesën e 1 specialistëve (Psikologe dhe Logopede) për Qendrën Ditore të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

Drejtoria e Çerdheve dhe Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

DREJTORI

Romina KALA



Nr. _____ prot.

Kavajë, më _____. _____. 2026

KERKESE

“PËR PER SHITESË TË PUNONJËSVE NE DREJTORINE E SHERBIMEVE”.

Nisur nga nevojat qe ka institucioni për të ushtruar autoritetin e tij në interesin e publikut vendor, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, duke u bazuar edhe në disa ndryshime ligjore të cilat kërkojnë detyrimisht numrin e përcaktuar të punonjësve, nevojitet shtimi i punonjësve konkretisht sipas shpërndarjes në Drejtorinë e Shërbimeve, për të realizuar sa më mirë procesin e shërbimeve baze dhe për të patur një ambjent sa më të pastër, kerkohen shtesat e punonjesve si me poshte:

Nente punonjes shërbimesh ne qytet,

Nje inxhinier ndertimi,

Nje inxhinier elektrik,

Kater shoferi dhe teknik te drejtimit te mjeteve si skrep, kamioncina etj,

Nje punonjes ne bordin e kullimit,

Kater roje,

Shtatë sanitare,

Kater punonjës shërbimi në Njësinë Administrative Golem,

Dy punonjës shërbimi në Njësinë Administrative Synej,

Dy punonjës shërbimi në Njësinë Administrative Luzi Vogël,

Dy punonjës shërbimi në Njësinë Administrative Helmas,

DREJTORI
MARJUS KOLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
INSPEKTORIATI MBROJTJES SË TERRITORIT VENDOR

Nr. _____ Prot.

Kavajë , më _____._____.2026

RELACION

Lënda: Propozim për shtim stafi ne Inspektoriatin Mbrojtjes se Territorit-Bashkia Kavajë.

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë z.Fisnik Qosja.

**Për Dijeni: Sekretarit të Përgjithshëm z.Adrian Malaj.
Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike z.Albi Lushka**

Në kuadër të rritjes së volumit të punës administrative, hartimit të akteve administrative si dhe shtimin në terren të lejeve të ndërtimit dhe inspektimin në terren të lejeve të miratuara nga Bashkia Kavajë si dhe evidentimin e ndërtimeve pa leje kërkojmë shtyrtimin e mundësisë për shtimin e 2 (dy) vendeve të punës në IMT-Bashkia Kavajë, konkretisht:

- 1 (një) specialist jurist.
- 1 (një) inspektor.

Për sa më sipër, lutemi që kërkesa jonë të merret në konsiderate për miratimin e shtimit të vendeve të punës në këtë Inspektoriat.

KRYEINSPEKTOR

Mehmet Reçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më ____ . ____ .2026

LENDË: Relacion për shtesë punonjesh në organikën e Drejtorisë së Burimeve Ekonomike
DREJTUAR: Drejtorisë së Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse

PER DIJENI: KRYETARI I BASHKISË

Në kuadër të përmirësimit të funksionimit të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike dhe rritjes së efikasitetit në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe administrative, paraqitet nevoja për shtesë në organikën aktuale me 3 (tre) specialistë të rinj në fushën e financës, kryesisht në Sektorin e Financës Kontabilitetit.

Stafi ekzistues është i ngarkuar mbi kapacitetet optimale, gjë që ndikon në afatet e përgatitjes së raporteve financiare dhe lind nevoja e shtesës në organikën e kësaj drejtorie.

Shtimi i 3 specialistëve do të mundësojë:

- Përmirësimin e menaxhimit dhe delegimit të funksioneve për çdo specialist;
- Rritjen e saktësisë dhe shpejtësisë së përgatitjes së raporteve financiare;
- Forcimin e kontrollit të brendshëm financiar;
- Uljen e ngarkesës në procesin e punës për stafin ekzistues.
- Përmbushjen në kohë të detyrimeve ligjore dhe raportuese.

Duke marrë parasysh rëndësinë e funksionimit të saktë dhe efikas të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike, si dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve njerëzore, propozohet miratimi i shtesës në organikë me 3 (tre) specialistë finance si më poshtë :

- 1-Specialist i Administrimit të Magazinës
- 2-Specialist për Sektorin Finance-Kontabilitet
- 3-Specialist për Raportimet Financiare periodike për MF, AMVV, DFV etj

Për këto arsye, kërkohet shqyrtimi dhe miratimi i këtij propozimi.

DREJTORI
ALBI LUSHKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E KULTURËS DHE SPORTEVE
DREJTORIA E TRASHËGIMISË KULTURORE, TURIZMIT DHE PROMOVIMIT TË QYTETIT

Nr _____ Prot

Kavajë me ____ / ____ /2026



RELACION

Lënda: Propozim për shtim stafi në Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve dhe në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Promovimit të Qytetit

Drejtuar: Kryetar i Bashkisë Z.FISNIK QOSJA

Për dijeni: Sekretari i Përgjithshëm Adrian Malaj

Për dijeni: Drejtor i Burimeve Ekonomike Z.Albi Lushka

Në kuadër të rritjes së aktiviteteve kulturore dhe sportive, nevojës për përmirësimin e organizimit dhe ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, si edhe për të promovuar sa më mirë Bashkinë e Kavajës duke qenë që turizmi përbën një nga të ardhurat kryesore, kërkojmë shqyrtimin e mundësisë për shtimin e 8 (tetë) vende pune në Drejtorinë e Kulturës dhe Sportit me pozicione si; 4 (katër) Specialist Sporti, 2 (dy) Specialist Kulture, 2 (Specialist Muzike) dhe 5 (pesë) vende pune në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Promovimit të Qytetit me pozicione si; 3 (tre) Specialist Turizmi, 2 (dy) Specialist Muzike.

Ngarkesa në rritje e punës, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore e sportive, si dhe nevoja për mbështetje më të madhe administrative dhe organizative, e bëjnë të domosdoshëm forcimin e kapaciteteve njerëzore të të dyjave drejtorive.

Për sa më sipër, lutemi të merret në konsideratë miratimi i shtimit të vendeve të punës, në funksion të përmbushjes sa më cilësore të detyrave institucionale.

DREJTOR I KULTURËS

GENTIAN JAUPI

DREJTOR I TURIZMIT

BASHKIM KRASNIQI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA LIGJORE**

Nr. _____ Prot.



Kavajë, më _____._____.2026

RELACION

Lënda: Propozim për shtim stafi në Drejtorinë Ligjore

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë z.Fisnik Qosja

Për dijeni: Sekretarit të Përgjithshëm z.Adrian Malaj
Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Ekonomike z.Albi Lushka

Në kuadër të rritjes së volumit të punës administrative dhe ligjore, ndjekjes së proceseve gjyqësore, shqyrtimit dhe hartimit të akteve administrative, si dhe nevojës për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe shërbimeve informatiketë institucionit, kërkohet shqyrtimin e mundësisë për shtimin e 5 (pesë) vendeve të punës në Drejtorinë Ligjore, konkretisht:

- 3 (tre) specialistë juristë
- 2 (dy) specialistë IT

Ngarkesa në rritje e punës, digjitalizimi i proceseve administrative, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, mbështetja teknike në çdo zyrë, si dhe nevoja për ndjekjen e procedurave administrative dhe çështjeve juridike, e bëjnë të domosdoshëm forcimin e kapaciteteve në këtë drejtori.

Sa më sipër, lutemi të merret në konsideratë miratimi i shtimit të vendeve të punës në këtë drejtori.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**DREJTORI
HELIDON PLAKU**